

MUNDËSITË E BARABARTA parashikohen me **LIGJ**

Është i jashtëligjshëm diskriminimi i përfituesve të ndihmës financiare federale në bazë të:

Racës, ngjyrës, fesë, gjinisë, prejardhjes kombëtare, moshës, aftësisë së kufizuar, pjesëmarrjes ose bindjes politike të çdo individi në Shtetet e Bashkuara; si dhe në bazë të shtetësisë/statusit të emigrantit të pranuar ligjërisht dhe të autorizuar për të punuar në Shtetet e Bashkuara ose pjesëmarrjes së tij ose të saj në ndonjë program apo veprimtari të ndihmës financiare sipas Kreut I të WIA-s, për çdo përfitues të programeve të ndihmës financiare sipas Kreut I të Ligjit të Investimit për Punonjësit, të vitit 1998 (Workforce Investment Act, WIA). Përfituesi nuk duhet të diskriminohet në asnjërin nga rastet e mëposhtme: në vendimmarrjen se cili do të pranohet ose do të ketë akses në ndonjë program ose veprimtari të ndihmës financiare sipas Kreut I të WIA-s; në ofrimin e mundësive ose trajtimin e një personi në lidhje me këtë program ose veprimtari, ose në marrjen e vendimeve të punësimit në zbatim ose në lidhje me këtë program ose veprimtari.

Çfarë duhet të bëni nëse mendoni se jeni diskriminuar

Nëse mendoni se jeni viktimë e diskriminimit në programin ose veprimtarinë e ndihmës financiare sipas Kreut I të WIA-s, mund të depozitoni ankesë brenda 180 ditësh nga data e shkeljes së supozuar, drejtuar:



**Department
of Labor**

Emri i marrësit, nëpunësi për mundësitë e barabarta:

Emri i organizatës:

Adresa:

Telefon:

Email:

Drejtori

Departamenti i Zhvillimit të Mundësive të Barabarta
(Division of Equal Opportunity Development)
New York State Department of Labor
State Office Campus, Building 12, Room 540
Albany, New York 12240

TELEFON: (518) 457-1984

(Thirrje nga personat me vështirësi dëgjimi) 1-800-662-1220

(Thirrje nga personat pa vështirësi dëgjimi) 1-800-421-1220

ose mund të depozitoni ankesë drejtpërdrejt te:

Drejtori

Qendra për të Drejtat Civile (Civil Rights Center, CRC)
U.S. Department of Labor
200 Constitution Avenue, NW
Room N-4123
Washington, D.C. 20210

Nëse e depozitoni ankesën te marrësi, duhet të prisni derisa marrësi të japë një njoftim me shkrim për vendimin përfundimtar ose të prisni që të kalojnë 90 ditë (cilado të ndodhë e para), përpara se ta depozitoni ankesën pranë Qendrës për të Drejtat Civile (shihni adresën më lart). Nëse marrësi nuk jep njoftim me shkrim për vendimin përfundimtar brenda 90 ditësh nga dita në të cilën keni depozituar ankesën, nuk keni pse të prisni më që marrësi ta japë atë njoftim për të depozituar ankesën pranë CRC-së. Megjithatë, ankesën tuaj te CRC-ja duhet ta depozitoni brenda 30 ditëve të afatit 90-ditor (pra, brenda 120 ditëve nga data kur keni depozituar ankesën pranë marrësit). Nëse marrësi ju jep njoftim me shkrim për vendimin përfundimtar për ankesën tuaj, por nuk jeni i kënaqur me vendimin ose me zgjidhjen, mund të depozitoni ankesë pranë CRC-së. Ankesën te CRC-ja duhet ta depozitoni brenda 30 ditëve nga data kur keni marrë njoftimin për vendimin përfundimtar.